



**YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET
PARTİSİ**

**PARTIA TURKE E LËVIZJES
NOVATORE**

PROGRAMI I PARTISË

2020 Prizren, Kosovë

P Ë R M B A J T J A

Hyrje - Objektivat

- 1. TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE**
- 2. PARIMI I SHTETIT DEMOKRATIK, LIGJOR, SEKULAR DHE SOCIAL**
 - a) Demokracia
 - b) Ligji - Sundimi i ligjit
 - c) Kuptimi i sekularizmit
 - d) Kuptimi i shtetit social
- 3. SIGURIMI I DREJTËSISË**
- 4. PËRGJEGJËSIA POLITIKE NË PUBLIK**
 - a) Transparenca dhe ndershmëria në administratën publike
 - b) Organizatat e shoqërisë civile
 - c) Mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të tjera të komunitetit
- 5. E DREJTA PËR PUNË - Puna e barabartë dhe e drejtë për të gjithë**
- 6. EKONOMIA – Politika jonë për zhvillimin ekonomik**
 - a) Ekonomia e Diasporës
 - b) Bujqësia, Blegtoria dhe Turizmi
- 7. POLITIKA E JASHTME – Një Kosovë e fortë dhe paqësore në politikën e jashtme**
 - a) Marrëdhënie të mira me vendet fqinje dhe miqësore
 - b) Pavarësia e plotë dhe anëtarësimi në **KB**
 - c) Përsheptimi i negociatave me BE-në dhe anëtarësimet
 - d) Mbrojtja e qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit
- 8. ADMINISTRIMI PUBLIK**
 - a) Shërbimet Publike dhe Menaxhimi
 - b) Lufta kundër ryshfetit dhe korrupsionit
 - c) Liria e shtypit, medias dhe komunikimit
- 9. POLITIKAT SOCIALE DHE ZHVILLIM**
 - a) Politika jonë për arsim
 - b) Sigurimi Social
 - c) Shërbimet Shëndetësore
 - d) Ruajtja e Kulturës, Artit dhe Historisë
 - e) Lufta Kundër Varfërisë dhe Papunësisë
 - f) Rinia dhe Sporti
 - g) Mjedisi dhe mbrojtja e mjedisit
 - h) Transporti dhe Trafiku urban



**YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET
PARTİSİ**

HYRJE

Qëllimi i themelimit të PARTISË TURKE E LËVIZJES NOVATORE; është një parti politike e krijuar për të prodhuar dhe zhvilluar politika novatore, demokratike dhe të bazuara në zhvillim, të cilat do t'i mundësojnë komunitetit Turk të Kosovës, e cila përbën një element në zhvillimin e vendit, për të parë të ardhmen me më shumë besim dhe për të mbrojtur dhe forcuar pavarësinë e vendit përgjithmonë.

Partia jonë është një platformë ku shteti laik-sekular, demokratik, shoqëror dhe kushtetues, demokratizimi, liria e besimit dhe barazia e mundësive pranohen si thelbësore në unitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa objektivat parësore të Partisë sonë janë:

- *Mbrojtja, luftimi dhe zhvillimi i të drejtave themelore të dhëna komunitetit Turk me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e tjera;*
- *Të mbrojtë dhe zhvillojë gjuhën Turke, traditat Turke dhe kulturën Turke në çdo fushë dhe kuptim;*
- *Të sigurohet që arsimit Turk të shihet dhe zhvillohet në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit publik;*
- *Duke marrë parasysh ekzistencën dhe mirëqenien e popullit tonë, sigurimi i mundësive të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve partiake dhe fillimin e iniciativave politike dhe shoqërore kudo që ka popullsi turke, kudo në Kosovë;*
- *Zgjedhja e përfaqësuesve në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në të gjitha komunat ku jetojnë turqit, duke pasur zë dhe duke qenë të përfaqësuar në institucione dhe organizata publike.*
- *Bazë e themelimit të Lëvizjes Novatore janë: dinjiteti dhe toleranca. Për këtë arsye do të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet, në zhvillimin e respektueshëm dhe socio-ekonomik të kulturës, traditave dhe arsimit të tyre.*
- *Të kontribuojë në çdo mënyrë në zhvillimin e vendit në fushat ekonomike, demokratike, ligjore dhe sociale dhe të bëjë të gjitha studimet e nevojshme për të rritur cilësinë e mirëqenies së shoqërisë;*
- *Të kryejë aktivitete në marrëdhëniet ndërkombëtare në përputhje me interesat e vendit dhe shoqërisë, të përfaqësojë vendin tonë në arenën ndërkombëtare në mënyrën më të mirë; të zhvillojë marrëdhënie të mira me vendet mike dhe fqinje, veçanërisht me institucionet dhe organizatat e Republikës së Turqisë;*

Duke qenë e dobishme në hapjen e një epoke të re në politikën turke të Kosovës, me objektivat e reja politike të inicuar nga **PARTIA TURKE E LËVIZJES NOVATORE**, ne OFROJMË PROGRAMIN POLITIK TË PARTISË, që do të kryejë të gjitha studimet dhe aktivitetet e nevojshme politike për të qenë një shtet i fortë, i qëndrueshëm dhe paqësor në politikën e brendshme dhe të jashtme, mbi të gjitha duke u dhënë përparësi njerëzve, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve, miratimit të parimeve juridike universale, ruajtjes së rendit demokratik dhe kontributit në procesin e demokratizimit të vendit, sigurimit të zhvillimit dhe rritjes në arsim, shëndetësi dhe ekonomi, mbështetjes së zhvillimit të faktorëve të prodhimit dhe kapitalit.

1. TË DREJTAT THEMELORE DHE LIRITË

"Të drejtat dhe liritë themelore", të cilat përbëjnë bazën e demokracisë moderne, duhet të sigurojnë që individët të kenë besim dhe liri nga shteti, të cilët besojnë se liritë si gjuha, feja, besimi, raca, gjinia respektohen, se liria e mendimit dhe e shprehjes nuk është e kufizuar në asnjë mënyrë dhe se nuk ka ndërhyrje në privatësinë e individëve. Nga ky këndvështrim, qëllimi kryesor i Partisë sonë është të sigurojë që individët të mund të veprojnë ashtu siç dëshirojnë brenda kornizës Kushtetuese dhe ligjeve.

Në përputhje me këtë objektiv, ajo ka një vullnet politik që do të kontribuojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave dhe lirive themelore.

2. PARIMI I SHTETIT DEMOKRATIK, LIGJOR, SOCIAL DHE SEKULAR

a) Demokracia

Kuptimi i demokracisë së Lëvizjes Novatore, fillon duke respektuar vullnetin e qytetarëve / votuesve që një shtet të jetë një vend demokratik. Me një demokraci të lirë, pluraliste dhe pjesëmarrëse, një administratë transparente dhe e ndershme synon politikën e vendit, beson se sovraniteti i takon popullit pa kushtëzime dhe miraton këtë mirëkuptim.

Parimi demokratik, është objektivi kryesor i partisë sonë. Do të merën të gjitha masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e rendit demokratik në vendin tonë, si dhe brenda partisë.

b) Ligji - Sundimi i ligjit

Shteti ligjor është një formë e shtetit në të cilin pushteti publik varet nga stabiliteti, vazhdimësia dhe ligji brenda kufijve të tij. Me këtë kuptim, Lëvizja Novatore do të ketë një strukturë të respektueshme dhe tolerante ndaj ligjit dhe sundimit të ligjit.

Lëvizja Novatore është e vendosur të bëjë që sundimi i ligjit të mbizotërojë në vend. Me këtë mirëkuptim, objektivi ynë kryesor është të sigurojmë kuptimin e një shteti ligjor, të bazuar në parimet e ligjit universal me të gjitha kushtet e tij.

c) Kuptimi i Shtetit Social

Parimi i shtetit social kërkon ndërhyrjen e shtetit për të arritur drejtësinë sociale dhe barazpeshën sociale. Nuk është e mundur të ndahen nga njëri tjetri shteti social dhe shteti ligjor. Ne e pranojmë që shteti social është një fazë e avancuar e shtetit ligjor.

Nën kuptimin e shtetit shoqëror, Partia jonë e konsideron veten përgjegjëse për prodhimin dhe zbatimin e politikave të ndryshme për çështje të tilla si shpërndarja e drejtë e të ardhurave dhe lufta kundër varfërisë, mundësitë e barabarta, sigurimet sociale, punësimi i plotë dhe lufta kundër papunësisë, sigurimi i ekuilibrit shoqëror dhe paqes, si dhe rritja ekonomike dhe zhvillimi. Partia jonë do të mbështesë të gjitha llojet e vullnetit politik dhe shoqëror për ndërtimin dhe zhvillimin e vendit.

d) Sekularizmi

Duhet të sigurohet që shteti të mos bëjë diskriminim bazuar në bindjet në marrëdhëniet e tij me qytetarët e tij dhe se kjo është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje.

3. SIGURIMI I DREJTËSISË

Për Lëvizjen Novatore, pavarësia e gjyqësorit dhe siguria e një gjyqtari janë kushtet thelbësore për zhvillimin e shtetit ligjor dhe demokracisë.

Qëllimi ynë kryesor është të bëjmë rregullime ligjore në mënyrë që të sigurojmë mbrojtje të kujdesshme të të drejtave universale siç janë e drejta për një gjykim të drejtë, siguria e gjyqarit, e drejta për të kërkuar dhe mbrojtur, e drejta për kërkesë, prezumimi i pafajësisë dhe liria për të kërkuar të drejtat dhe për të zbatuar këto të drejta në të gjitha fushat e rendit gjyqësor.

Në mënyrë që procesi gjyqësor të jetë i shpejtë dhe efektiv, do të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme për të zgjidhur shpejtë problemet që dalin nga legjislacioni ose aplikacioni dhe për të bërë rregullore të reja ligjore ose administrative.

4. PËRGJEGJËSIA POLITIKE NË PUBLIKË

a) Transparenca dhe ndershmëria në administratën publike

Politika është një fushë e detyrave publike. Të shohësh politikën si një burim të ardhurash është e papajtueshme me detyrat publike. Për këtë arsye, sigurimi i menaxhimit të pastër dhe të ndershëm në të gjitha nivelet është qëllim parësor për Lëvizjen Novatore.

Të gjithë përfaqësuesit e partisë sonë janë të detyruar t'i përmbushin detyrat dhe kompetencat e tyre të dhëna me ligje dhe rregullore, në mënyrë që të sigurojnë besimin shoqëror në detyrat e tyre publike dhe jetën shoqërore, veçanërisht në punën partiake. Përveç kësaj, të gjithë punonjësit

duhet t'i kryejnë detyrat e tyre me një mirëkuptim të pastër dhe të ndershëm politik, me synimin dhe vetëdijen për t'i shërbyer vetëm popullit dhe shtetit tonë.

b) Organizatat e shoqërisë civile (Organizatat jo-qeveritare)

Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ-të), janë organizata që mbrojnë strukturën shoqërore në komunitet dhe mbrojnë karakteristikat dhe bukuritë rajonale. Këto organizata japin një kontribut të madh në çlirimin e mendimit shoqëror dhe rritjen e cilësisë politike.

Për një strukturim më kualitativ dhe administrativ të Institucioneve-Organizatave Jo-Qeveritare Turke, për sa i përket identitetit institucional, Partia do të ofrojë të gjitha llojet e mbështetjes duke siguruar kontribuimin dhe koordinimin e nevojshëm.

Nga ana tjetër, me lidhjet tona të bashkëpunimit me shumë institucione publike dhe organizata joqeveritare të cilat veprojnë në Republikën e Turqisë, synohet zhvillimi i veprimtarive të organizatave joqeveritare që do të ndikojë në forcimin e lidhjeve midis dy vendeve.

c) Mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të komuniteteve tjera

Të gjitha komunitetet etnike që jetojnë në Kosovë përbëjnë pasurinë e shtetit tonë.

Synohet të sigurohet që të drejtat e komuniteteve etnike për të punuar në arsim, kulturë, besim dhe sferë publike të jenë më të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet, të ndryshohen nenet përkatëse të Kushtetutës dhe ligjeve përmes konsensusit që do të arrihet në parlament, në mënyrë që të sigurohet që secili komunitet etnik të ketë lirinë për të shprehur veten në gjuhën e tyre dhe për të mbrojtur të drejtat e pakicave që jetojnë në Kosovë, si dhe për të përmbushur nevojat e tyre.

Ne si Parti, duke mos pranuar çfarëdo sulmi sulmi ndaj simboleve dhe identiteteve kombëtare, kulturës dhe traditave të të gjitha komuniteteve, do të bëjmë përpjekje për të ndërmarrë masat e nevojshme dhe për të rritur sanksionet penale kundër akteve të urrejtjes dhe dhunës.

5. E DREJTA PËR PUNË DHE SIGURIA NË PUNË

Si element themelor i të kuptuarit të shtetit shoqëror, beson se të gjithë duhet të kenë të drejtën të punojnë. Nevojiten masa dhe reforma serioze për shkak të problemit të papunësisë në vendin tonë dhe migrimit të të rinjve në Evropë. Derisa shteti dhe qeveria janë përgjegjëse kryesore, edhe sektori privat gjithashtu duhet të mbështesë shtetin në këtë drejtim.

Objektivat tona prioritarë janë qështjet e tilla si eliminimi i problemit të papunësisë, krijimi i mundësive të punësimit, siguria në punë dhe sigurimi i punës. Së pari, duhet të merren masa ligjore për të parandaluar punësimin e paligjshëm dhe pa sigurim, si dhe largimet arbitrare.

6. EKONOMIA – POLITIKA JONË PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK

Përmbledhje

Qëllimi i **PARTISË TURKE E LËVIZJES NOVATORE** në ekonomi është mirëqenia dhe lumturia e qytetarëve tanë. Në këtë aspekt, shteti i Kosovës është një vend i përshtatshëm për zhvillim ekonomik për shkak të vendndodhjes së tij gjeografike. Partia jonë do të mbështesë të gjitha llojet e reformave që mbështesin zhvillimin socio-ekonomik të komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit. Për këtë arsye, edhe për zhvillimin dhe përmirësimin e vendit:

a) Ekonomia e Diasporës:

Një nga objektivat më të rëndësishëm ekonomik të Partisë sonë është të sigurojë stimuj, përparësi dhe mundësi të ndryshme në drejtim të lehtësimeve në investim dhe zhvillim të bashkëpunimit tregtar, veçanërisht për qytetarët dhe bashkatdhetarët tanë që jetojnë jashtë dhe janë aktivë në botën e biznesit ndërkombëtar.

Në këtë kontekst,

- *Përmirësimi i kushteve ligjore në njohjen e së drejtës për nënshtetësi,*
- *Garantimi i së drejtës për punë dhe siguri në punë,*
- *Garancia shtetërore dhe përjashtimi-lirimi nga taksat,*
- *Prioriteti në tenderët publik,*
- *Ndryshimet ligjore që duhet të trajtohen urgjentisht, të tilla si... dhënia përparësi në procedurat ligjor për dhënien me qira afatgjate të paluajtshmërive publike dhe komunale.*

b) Bujqësia, Blegtoria dhe Turizmi

Për të siguruar rritje në ekonomi, duhet të sillen reforma të reja në drejtim të zhvillimit, veçanërisht në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit, dhe për stabilitetin zhvillimor duhet të sigurohen mundësitë e nevojshme të infrastrukturës. Është e pashmangshme të kryhen studime që mund të aktivizojnë potencialin tonë të zhvillimit në bujqësi dhe blegtori dhe të shesin produkte si në tregjet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Duke marrë parasysh strukturën gjeografike dhe kushtet klimatike të vendit, duhet të mbështeten ndërmarrjet që merren me blegtori dhe duhet të zbatohen masat e nevojshme.

Vendi ynë është një vend i hapur për turizëm dhe ka potencial me historinë, traditat, pasurinë kulturore dhe bukuritë natyrore. *Programi ynë i zhvillimit ekonomik do të përfshihet në Deklaratën Zgjedhore dhe do të bëhen përparime të nevojshme politike brenda kornizës së programit qeveritar.*

7. POLITIKA E JASHTME – NJË KOSOVË E FORTË DHE PAQËSORE NË POLITIKËN E JASHTME

PARTIA TURKE E LËVIZJES NOVATORE, avokon që vendi ynë duhet të ndjekë një politikë të përhershme, konstruktive dhe të vendosur në arenën ndërkombëtare dhe të ketë një strukturë efektive dhe të fuqishme të politikës së jashtme në marrëdhëniet politike ndërshtetërore.

Kuptimi themelor i Partisë sonë është të kemi një kuptim të politikës së jashtme që ka marrëdhënie të përhershme dhe të qëndrueshme me vendet fqinje dhe miqësore dhe të kemi një politikë të vendit që kontribuon për paqen në botë dhe sigurinë e njerëzve.

a) Marrëdhënie të mira me vendet fqinje dhe mike

Në politikën e jashtme, Lëvizja Novatore është në favor të sigurimit të paqes dhe prosperitetit në territorin e Kosovës, garantimit të paqes dhe sigurisë në rajon, krijimit të marrëdhënieve të qëndrueshme miqësore me të gjitha vendet e Ballkanit dhe Evropës, veçanërisht me fqinjët tanë si dhe zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike. Sidoqoftë, këto marrëdhënie duhet të zhvillohen me kusht që ato të mos dëmtojnë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, Kushtetutën dhe strukturën demokratike të shtetit. Besojmë se proceset e njohjes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar që ekzistojnë me vendet në rajon duhet të kryhen bazuar në parimet e dialogut dhe konsensusit.

Marrëdhëniet midis Republikës mike të Turqisë, e cila e mbështet vendin tonë në çdo fushë dhe në çdo kuptim, dhe Republikës së Kosovës, ka një rëndësi të madhe për komunitetin Turk. Të gjitha institucionet dhe organizatat e komunitetit Turk të Kosovës, të afërmit e tyre dhe Partia jonë, janë të gatshëm të marrin të gjitha llojet e detyrave dhe përgjegjësisive për t'i bërë këto marrëdhënie të përhershme dhe të qëndrueshme midis dy vendeve mike.

b) Pavarësia e plotë dhe anëtarësimi në KB

Republika e Kosovës është një vend i pavarur sovran dhe i pandashëm me vendin dhe kombin e shtetit. Në këtë drejtim, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, pavarësia e Kosovës duhet të njihet në Asamblenë e Përgjithshme të **OKB-së** dhe duhet të respektohen të drejtat e saja të plota sovrane.

Është shumë e rëndësishme të kryhen aktivitete lobuese dhe inkurajuese në mënyrë që vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pranë KB (ICJ) me 22 korrik 2010 që shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës, nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare të pranohet si pozitive nga shtetet e tjera.

c) Përshpejtimi i negociatave me BE dhe NATO dhe anëtarësimet

Prania e Republikës së Kosovës midis shteteve anëtare të BE-së dhe NATO-s është e pashmangshme për paqen dhe stabilitetin e rajonit. Ne avokojmë që standardet e aplikuara për vendet e tjera candidate gjatë proceseve të anëtarësimin në BE dhe NATO duhet të zbatohen edhe për Republikën e Kosovës.

Ne avokojmë se probleme të tilla si "e drejta për lëvizje të lirë dhe heqja e vizave" që parandalojnë lirinë e lëvizjes dhe tregtinë ndërkombëtare, duhet të zgjidhen sa më shpejtë të jetë e mundur dhe këto kufizime duhet të hiqen në kohë sa më të shkurtër.

Për **PARTINË TURKE E LËVIZJES NOVATORE**, ruajtja e marrëdhënieve me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe NATO-s është një nga çështjet më të rëndësishme të politikës së jashtme të shtetit të Kosovës që duhet të zgjidhet në afat të shkurtër.

d) Mbrojtja e qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit

Në kuptimin e politikës sonë të jashtme, mbrojtja e familjeve që migruan nga Kosova në vende të tjera në periudha të ndryshme pas vitit 1900 dhe brezave të tyre, është ndër fushat tona prioritare të punës.

Është shumë e rëndësishme që të rinjohim të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës ndaj të afërmeve tanë dhe pasardhësve të tyre, të cilët migruan në kohë të ndryshme. Disa dispozita në legjislacionin aktual duhet të ndryshohen dhe proceset administrative duhet të lehtësohen. Si rezultat, do të vendosen miqësitë midis vendeve, do të vendosen marrëdhëniet e reja midis familjeve dhe veçanërisht do të zhvillohen marrëdhëniet ekonomike, kulturore dhe sociale.

Procesi aktual i procedurave të zgjedhjeve duhet të përmirësohet dhe lehtësohet në ushtrimin e së drejtës së zgjedhjes për qytetarët tanë që jetojnë jashtë. Sidomos aplikimi i procedurave të votimit të drejtpërdrejtë ka një rëndësi të madhe për procesin e demokratizimit.

Këto praktika, të cilat ne besojmë se do të kontribuojnë shumë në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, janë të rëndësishme për marrëveshjet e reja midis vendeve dhe për investimet e huaja që do të vijnë në vendin tonë.

8. ADMINISTRATA PUBLIKE – SYNIMI YNË NË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Si **PARTI TURKE E LËVIZJES NOVATORE**, të kuptuarit tonë të administratës publike, duke marrë parasysh elementet e shtetit demokratik dhe social, duhet të përdorë fuqinë dhe kompetencat e shtetit brenda kornizës së "kushtetutës dhe ligjeve", për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve tanë, për të siguruar sigurinë e jetës dhe pronës, për të siguruar që shoqëria të jetojë në paqe dhe qetësi.

Duhet të miratohet një qasje moderne e administratës publike që është e përshtatshme për nevojat e qytetarëve tanë, duke siguruar shërbime publike të shpejta, ekonomike, efikase, dhe efektive. Prandaj, kuptimi ynë i administratës publike do të jetë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

a) Shërbimet Publike dhe Menaxhimi

Është e pashmangshme për qeverinë qendrore dhe qeveritë lokale të miratojnë praktika të reja shërbimi në mënyrë që të ofrojnë shërbim më të mirë dhe më të shpejtë për qytetarët tanë, duke hequr të gjitha pengesat që e bëjnë jetën e qytetarëve tanë të vështirë dhe duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit.

Administratat lokale - komunat duhet të miratojnë një qasje të orientuar drejt njerëzve derisa përdorin kompetencat e tyre dhe duhet të vazhdojnë aktivitetet e tyre pa cenuar sundimin e ligjit. Qeveritë lokale; qëllimi ynë më i madh është të shohim komuna që janë demokratike, pluraliste, pjesëmarrëse, efektive, të përgjegjshme, më transparente dhe të zhvilluara në qasjen në shërbimet e informacionit, si në vendet moderne dhe të zhvilluara.

b) Luftimi i Ryshfetit dhe Korrupsionit

Si parti jemi të vendosur thellësisht që të luftojmë në veçanti ryshfetin dhe korrupsionin që rezultojnë nga abuzimi i pushtetit publik, favorizimin, manipulimin me ofertat e tenderëve, që është joetike dhe jomorale, si dhe keqpërdorimin e interesave publike në favor të interesave private.

c) Liria e shtypit, medias dhe komunikimit

Të gjithë dhe çdo komunitet duhet të jenë të lirë që brenda kornizës së lirisë së shtypit, të kryejnë veprimtari mediale lirshëm, me kusht që të respektohen parimet e Kushtetutës dhe të drejtat e njeriut, si dhe integritetin e vendit dhe të drejtat dhe liritë individuale.

Transmetimi për çdo komunitet në kushte të barabarta, krijimi i një grupi mediatik, bërja e transmetimeve audio, të shkruara dhe vizuale dhe mbrojtja e gjuhës dhe kulturës së të gjitha komuniteteve duhet të garantohet me Kushtetutë.

9. POLITIKAT SOCIALE DHE ZHVILLIM

a) *Politika jonë në arsim*

Arsimi është rruga e mendjes dhe e ndriçimit. Arsimi është i domosdoshëm për zhvillimin më të shpejtë të një shoqërie. Në këtë aspekt, qëllimi i partisë sonë është të mbështesë zhvillimin e arsimit dhe ndriçimit të shoqërisë në vendin tonë.

Suksesi që do të arrihet me reformat në fushën e arsimit do të rrisë cilësinë totale të fushave të tjera. Në këtë drejtim, përparësia në alokimin e burimeve publike si shtet duhet të parashikojë investimin e nevojshëm në arsim.

Si Lëvizje Novatore, ne do të bëjmë përpjekjet e nevojshme në punët tona politike për të kaluar në një sistem arsimor modern dhe për të rritur breza etikë, të kulturuar dhe cilësorë. Në këtë drejtim, veprimet tona do të kryhen në fushën e arsimit nën katër tituj kryesorë.

- Sistemi bashkëkohor i arsimit kualitativ
- Arsimim i barabartë për të gjithë
- Arsimim i Lartë
- Njohuri mbi moralin, Edukimi Sportiv dhe Edukim i gjuhëve të huaja

Programi ynë i cili mbështet zhvillimin e arsimit do të përfshihet në Deklaratën Zgjedhore.

b) Sistemi i Sigurimeve Sociale

Partia e pranon sigurimin shoqëror si një nga të drejtat themelore dhe kushtetuese brenda fushës së kuptimit të shtetit shoqëror dhe beson se të gjithë duhet të përfitojnë nga kjo e drejtë, pavarësisht nga feja, raca apo gjinia. Për këtë arsye, duhet të zbatohet një reformë e re e sigurimeve shoqërore në përputhje me mirëkuptimin e gjendjes sociale për të gjithë individët, siç janë punonjësit, pensionistët, të papunët, fermerët, gratë, të varfërit... të cilët i përshtaten nderit dhe dinjitetit njerëzor.

Fuqia punëtore që punon pa sigurime shoqërore është e pasigurt, veçanërisht përballë rreziqeve të ndryshme shëndetësore siç janë sëmundja, aksidenti në punë dhe invaliditeti. Në këtë drejtim, legjislacioni ligjor duhet të zbatohet menjëherë dhe duhet të sigurohet fondi i nevojshëm i sigurimeve shoqërore.

c) Shërbimet Shëndetësore

Shëndeti është një e drejtë e domosdoshme për komunitetin. Secili ka të drejtë të përfitojë nga shërbimet shëndetësore pavarësisht racës, gjuhës, fesë, gjinisë. Shteti është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe moderne të kujdesit shëndetësor, pavarësisht nga ndryshimet ekonomike dhe sociale. Ofrimi në kohë i shërbimeve shëndetësore është një element i domosdoshëm i të kuptuarit të shtetit social.

Partia jonë është e mendimit se gjatë ekzekutimit të shërbimeve shëndetësore, të gjithë në shoqëri duhet të përfitojnë nga këto shërbime pa ndonjë diskriminim brenda kornizës së mirëkuptimit të shtetit social. Shteti është përgjegjës për ofrimin e të gjitha llojeve të mundësive dhe kushteve të shërbimit shëndetësor në realizimin e shërbimeve shëndetësore. Duhet të përshpejtohen të gjitha proceset dhe procedurat administrative në mënyrë që qytetarët tanë të përfitojnë nga shërbimet shëndetësore.

Programi ynë mbi sistemin shëndetësor, shërbimet shëndetësore, të drejtat e pacientit dhe punonjësve do të përfshihet në Deklaratën Zgjedhore.

d) Ruajtja e Kulturës, Artit dhe Historisë

Partia jonë mbështet të drejtat në vlerat e tyre universale të të gjitha komuniteteve etnike, veçanërisht komunitetit turk. Lëvizja Novatore respekton kulturën, artin dhe historinë e të gjitha komuniteteve. Në këtë aspekt, vlera dhe interesi që do të tregojmë si shtet në fushat e historisë, kulturës dhe artit, do të rrisin prestigjin e vendit tonë si në rajon ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Partia jonë është e gatshme të ofrojë të gjitha llojet e mbështetjes dhe shërbimeve veçanërisht për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave historike, kulturore dhe artistike dhe për zbulimin e vlerave të komunitetit turk. Në këtë kontekst, ajo do të kryejë projekte dhe studime të përbashkëta me të gjitha organizatat dhe individët përkatës joqeveritarë.

e) Luftimi i varfërisë dhe papunësisë

Varfëria dhe papunësia janë problemet më të mëdha të vendit tonë. Shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë në vendin tonë ndikojnë negativisht në vendin tonë në aspektin ekonomik dhe social. Në këtë drejtim, zbatimi i politikave të punësimit brenda kornizës së projekteve të zhvillimit dhe ngritjes ekonomike, pashmangshmërisht do të minimizojë nivelin e varfërisë dhe të papunësisë..

Stabiliteti dhe rritja që do të arrihet në ekonomi do të drejtojë shumë sektorë drejt prodhimit, dhe si rezultat i rritjes së prodhimit, do të arrihet një ulje e nivelit të papunësisë. Duke punësuar një "popullatë të re me kualifikime cilësore" e cila do të sigurojë dhe mbështesë mirëqenien sociale të vendit tonë, do të zbatohen politika të reja zhvillimore.

f) Rinia dhe Sporti

Rinia është pasuria më e madhe e vendit tonë. Qëllimi më i madh i partisë tonë është të realizojë politika që do të mundësojnë rininë tonë të rritet si individë me mendje të lirë, të vetëvendosur, argumentues, produktiv, të përgjegjshëm, të ditur, të kulturuar, të arsimuar dhe bashkëkohor.

Në Deklaratën Zgjedhore që do të përgatitet nën emrin e Rinisë Novatore, do të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm që veçanërisht të drejtat demokratike dhe ligjore të të rinjve të mos preken, të hiqen barrierat ekonomike dhe ata të mbrohen plotësisht nën shtetin social, të bëhet punësimi i tyre në sektorin publik dhe privat, të sigurohet pjesëmarrja e tyre në politikë dhe në proceset e vendimmarrjes, si dhe të sigurohet pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete shkencore, sociale, kulturore dhe artistike..

g) Mjedi dhe Mbrojtja e Mjedisit

Të jetuarit e komunitetit në një mjedis të pastër duhet të jetë e drejta themelore më e rëndësishme e njeriut. Në këtë aspekt, objektivi më i rëndësishëm i partisë sonë është të ndërmarrë të gjitha masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit dhe të krijojë një mjedis të shëndetshëm jetese.

Mirëpo, si shoqëri apo individ, problemin moral në mos mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, problemin e kompatibilitetit, e për këtë arsye edhe pasojat e dëmtimeve në mjedis nga ndotja e ajrit, fatkeqësisht nuk i marrin seriozisht.

Programi ynë novator për mjedisin dhe mbrojtjen e mjedisit do të përfshihet në Deklaratën Zgjedhore.

h) Transporti dhe Trafiku

Problemi i transportit dhe trafikut është një nga problemet kryesore të vendit tonë. Ekziston një situatë komplekse si rezultat i aksidenteve të trafikut që rriten çdo vit, përdorimit të automjeteve pa ndjenja, mangësive në planifikimin mjedisor dhe të transportit, si dhe zbatimeve të gabuara.

Cilët janë zinxhirët e neglizhencës në ndodhjen e aksidenteve të trafikut në vendin tonë, arsyet e tyre, cilat janë mangësitë në legjislacionin ligjor dhe administrativ, provimet e testit të licencës dhe rezultatet e tyre duhet të hetohen dhe analizohen.

Për t'u bërë një vend dhe shoqëri mike me mjedisin, është e nevojshme të zvogëlohet përdorimi i automjeteve me gaz dhe karburant dhe të rritet përdorimi i transportit publik dhe automjeteve mike me mjedisin.

Data e miratimit: 21 Shtator 2020

Prizren